



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



UNITED NATIONS
ALBANIA



FUQIZIMI I SHKOLLAVE DHE MËSUESVE NDIHMËS PËRMES BASHKËPUNIMIT DHE SHKËMBIMIT ME QENDRAT E SHËRBIMEVE KOMUNITARE PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA





Leave
No One
Behind



Përmbajtja

- *Parathënie*
- *Veprimtari të realizuara nga bashkëpunimi i mësuesve ndihmës dhe qendrës komunitare në Pogradec*
- *Veprimtari të realizuara nga bashkëpunimi i mësuesve ndihmës dhe qendrës komunitare në Shijak*
- *Veprimtari të realizuara nga bashkëpunimi i mësuesve ndihmës dhe qendrës komunitare në Urën Vajguore*
- *Veprimtari të realizuara nga bashkëpunimi i mësuesve ndihmës dhe qendrës komunitare në Lushnjë*




Fuqizimi i shkollave dhe mësuesve ndihmës përmes bashkëpunimit dhe shkëmbimit me qendrat e shërbimeve komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën për të qenë të sigurtë, për të marrë shërbime dhe mbështetje me cilësi të lartë dhe të përqendruar te individit, dhe të kenë akses në shërbime për të cilat ata kanë nevojë për të rritur pavarësinë dhe zgjedhjen, dhe për të bërë të mundur që ata të kenë një jetë të përmbushur. Kjo e drejtë bazë është themelore për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara do të mbështetet dhe nxitej më tej nëse institucionet arsimore dhe mësuesit ndihmës do të bashkëpunonin me partnerë të tjerë që mund të ofrojnë shërbime dhe mbështetje në nivel lokal, sic janë edhe me Qendrat e Shërbimeve Komunitare pranë Bashkive. Puna me fëmijët me aftësi të kufizuara nuk duhet të mjaftohet vetëm me atë që bëhet gjatë kohës së qëndrimit në shkollë, por edhe më pas në familje apo në institucionet komunitare që ofrojnë shërbime sociale për këta fëmijë. Specialistët pranë këtyre qendrave janë potenciale shumë të mirë për të mbështetur shkollat dhe mësuesit në ofrimin e mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Nisur nga ky qëllim i lartpërmendur, në kuadrin e Projektit ‘Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar’ zhvilluar si pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas/Leve No One Behind (LNB)” implementuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), ASCAP ndërmoi një proces për nxitjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e kapaciteteve të mësuesve ndihmës në arsimin parauniversitar si dhe specialistëve në Qendrat komunitare pranë disa bashkive.




Në këtë proces u bë përpjekje për të identifikuar dhe nxitur strategjitë dhe format më efektive për bashkëpunimin mes institucioneve arsimore dhe institucioneve komunitare vendore, në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në bashkitë Lushnjë, Pogradec, Shijak dhe Urë vajgurore.

Krahas ngritjen e kapacitetit të mësuesve ndihmës dhe specialistët në Qendrat komunitare ky proces u fokusua dhe shënoi arritje në drejtim të:

1. Shkëmbim eksperiencash;
2. Shkëmbim informacionesh; dhe
3. Fuqizimin e marrëdhënieve të mësues ndihmes-prindër-specialist.

Pas mbështetjes së dhënë, qendrat komunitare që ofrojnë shërbime dhe mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara së bashku me shkollat dhe mësuesit ndihmës që mbështesin zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhanë shembuj të bashkëpunimit të efektshëm duke shtuar dhe fuqizuar mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara që frekuentojnë këto institucione.

Në vazhdim, janë prezantuar disa nga veprimtaritë e realizuara në kuadër të këtij bashkëpunimi Lushnjë, Pogradec, Shijak dhe Urë vajgurore. Këto veprimtari u bënë të mundura nga drejtuesit e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës në këto rrethe, mësuesve ndihmës anëtarë të këtyre rrjeteve si dhe drejtueseve dhe specialisteve në qendrat komunitare që ofrojnë shërbime për këta fëmijë.



VEPRIMTARI TË REALIZUARA NGA BASHKËPUNIMI I MËSUESVE NDIHMËS DHE QENDRËS KOMUNITARE NË POGRADEÇ





Veprimtaria 1

Të flasim me të njëjtën gjuhë

Shkëmbim eksperiencash midis mësuesve ndihmës të shkollave dhe kopshteve publike dhe specialistëve të Qendrës komunitare për personat me aftësi të kufizuara do të ndihmojnë që gjithpërfshirja në shkolla dhe kopshte të jetë produktive.

a) Qëllimi:

Veprimtaria synon

- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikat e punës me fëmijët e spektrit autik (nëpërmjet demonstrimit të specialisteve)
- Metodën e përbashkëta gjatë orëve të mësimit në klasa dhe në terapi do të sjellin rezultate të dukshme me fëmijët e spektrit autik.
- ADHD/Menaxhimi i sjelljes nëpërmjet Analizës së Sjelljes duke demonstruar raste konkrete e bëjnë më efikase punën me fëmijët autik dhe hiperaktive.

b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës që punojnë në shkolla dhe kopshte të arsimit bazë.
- Mësues specialistë që punojnë në Qendrën Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Pogradec.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Për shkak të situatës të Covid 19 pjesëmarrësit u ndanë në 3 grupe (nr i pjesëmarrësve 31). Në oraret 10:30_12:00, 12:00_13:30 dhe 13:30_15:00.

Pas prezantimit të pjesëmarrësve, u theksua rëndësia e këtij takimi dhe u bë një përshkrim mbi autizmin dhe rëndësinë e diagnostikimit nga drejtuesja e qendrës.

Diskutimi i rasteve konkrete dhe shkëmbimi i përvojave duke pasur parasysh kushtet dhe hapësirat në institucionet përkatëse, ishin një motivim për të qenë të gjithë pjesëmarrësit aktive në veprimtari.


Duke marrë një informacion më të gjerë mbi ADHD dhe menaxhimin e sjelljes u diskutua mbi analizën e sjelljes dhe rezultatet që na sjell përdorimi i formatit ABC.


Pjesëmarrësit njehsuan dhe përcaktuan përdorimin e metodave të njëjta dhe më efikase që dolën gjatë diskutimeve dhe demonstrimeve konkrete në mënyrë që mësimdhënia dhe terapia me fëmijët e spektrit autik të jap rezultate të kënaqshme si p.sh:

Si të jemi vëzhgues të mirë duke përcaktuar detyrat javore. Si të përcaktojmë detyrat dhe metodat e njëjta (si nga mësuesit ndihmës edhe nga terapistët) që gjithëpërfshirja të jetë konkrete. Si të përdorim Analizën e Sjelljes në funksion të punës sonë.

Në vazhdimësi ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë duke përcaktuar temat që do të dalin nga pyetësi i cili iu shpernda pjesëmarrësve në fund .

Foto nga veprimtaria 1





Veprimtaria 2

Mësuesit ndihmës marrin pjesë dhe ndjekin një orë terapie që zhvillohen në Qendrën Komunitare

a) Qëllimi:

Veprimtaria synon ngritjen e kapaciteteve të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikat e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të spektrit autik, (duke parë konkretisht zhvillimin e një ore terapie nga specialistët në qendër).


b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës që punojnë në shkolla dhe kopshte të arsimit bazë.
- Mësues specialistë që punojnë në Qendrën Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Pogradec.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Mësuesit ndihmës sipas dëshirës së tyre duke marrë për bazëfëmijët të cilët janë nëpër shkolla dhe kopshte dhe njëkohësisht frekuentojnë Qendrën, caktuan oraret për të qenë dëgjuese në orë terapie me specialistët. Mësueset morën informacionin e nevojshëm për mënyrën e menaxhimit të një sjellje agresive, mënyrën e kalimit nga një rubrikë tek tjetra, përdorimin e metodave të njëjta si në terapi edhe në klasë. Gjatë kësaj veprimtarie mësuesit ndihmës morën informacione praktike dhe të rëndësishme për punën e tyre, duke krijuar paralelisht një kontakt të ngushtë shkëmbim eksperiencash me specialistët, gjë që do të sjellë rezultate pozitive dhe të kënaqshme në punën e dy institucioneve. Qendra shprehu gatishmërinë të mirëpresë në çdo moment mësuesit ndihmës për të qenë pjesë e orëve të terapisë dhe për të punuar me të njëjtën metodë duke shkëmbyer eksperiencat e punës së tyre.

Foto nga veprimtaria 2





Veprimtaria 3

Bashkëpunimi mësues ndihmës dhe specialistët e Qendrës në ambientet e shkollave publike.

a) Qëllimi:

Veprimtaria synon forcimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve (shkollë publike dhe qendër) për të bërë sa më të përshtatshme ambientet brenda shkollave për fëmijët e spektrit autik.

b) Pjesëmarrësit:


- Mësues ndihmës që punojnë në shkolla dhe kopshte të arsimit bazë.
- Mësues specialistë që punojnë në Qendrën Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara në Pogradec.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Një ekip specialistësh nga qendra duke u bazuar në kërkesat e mësuesve ndihmës dhe në bashkëpunim me psikologët e shkollave, bënë vizita në dy shkolla të qytetit. Specialistët u bënë pjesë e orëve të mësimit, duke dhënë udhëzime për përgatitjen e dosjeve të materialeve të punës të cilat bazohen në metodat për forcimin e njohurive akademike. Shkëmbimi i informacioneve u fokusua tek metodat dhe materialet që duhet të përdorim që fëmijët e spektrit autik të jenë pjesë e orës së mësimit, duke eliminuar momentet shqetësuese për nxënësit e tjerë. Këto vizita do të vazhdojnë edhe në shkollat dhe kopshtet e tjera.

Foto nga veprimtaria 3





Veprimtaria 4

Përgatitja e materialeve për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara. Shkëmbim eksperiencash dhe idesh për materialet e punës që mund të përdorin mësuesit ndihmës dhe terapistët e qendrës, përgatitja e materialeve të njëjta, shkëmbimi i ideve, do të çojnë në rritjen e cilësisë së metodave mësimdhënëse për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijë të spektrit autik.

a) Qëllimi:

Veprimtaria synon ideimin dhe përgatitjen e materialeve të domosdoshme për të rritur aftësitë përfituese të fëmijëve me aftësi të kufizuara në orët e mësimi në shkolla dhe kopshte publike. (Kjo arrihet duke iu ofruar mësuesve ndihmës ambientet dhe materialet me të cilat do përgatiten mjetet mësimore).

b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës të shkollave dhe kopshteve
- Specialistë të Qendrës Komunitare për PAK në Pogradec

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Për shkak të ruajtjes së distancës dhe sigurisë së pjesëmarrësve në kushtet e pandemisë, trajnimi u bë në tre seanca nga ora 10.30 deri në 15.00. Pasi u bë një përshkrim nga drejtuesja e qendrës, për rëndësinë e materialeve të terapisë të cilat janë të domosdoshme për të rritur aftësinë përfituese të informacionit në klasë, u demonstruan për mësuesit përgatitja e disa mjeteve.

U bë një seleksionim të mjeteve për fushat në të cilat përdoren (matematikë, shkrim, terapi okupacionale etj). Në këtë seance trajnimi aktorët ishin shumë aktive dhe u vendos që në të ardhmen mësuesit ndihmës do të bashkëpunojnë me qendrën për përgatitjen e materialeve mësimore.

Foto nga veprimtaria 4



VEPRIMTARI TË REALIZUARA NGA BASHKËPUNIMI I MËSUESVE NDIHMËS DHE QENDRËS KOMUNITARE NË SHIJAK





Veprimtaria 1

Bashkëpunimi terapist - mësues ndihmës për hartimin e Planit Edukativ Individual të fëmijës që ndjek shkollën dhe merr shërbime në qendrën komunitare në Shijak.

a) Qëllimi:

- Njohja konkrete e punës së terapistëve në qendër me fëmijë që ndjekin terapi në qendër.
- Identifikimi i nevojave të fëmijës që ndjek qendrën dhe përshtatja e tyre në objektiva në planin e punës edhe në shkollë.
- Rritja e efektivitetit të planit PEI në shkollë, përmes njohjes me teknika specifike të punës në qendër.

b) Pjesëmarrësit:

Pjesë e takimit u bënë:

- terapistët e qendrës,
- mësuesja ndihmëse në shkollën në Rreth, dhe
- psikologja e shkollës.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Fillimisht, terapistët e qendrës prezantuan dhe demonstruan konkretisht punën me fëmijën gjatë terapisë.

Në vijim, gjatë ndjekjes së terapisë u evidentuan pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës, si dhe u diskutuan planet individuale të fëmijës të hartuara nga qendra dhe shkolla. U identifikuan aspektet në të cilat objektivat në vijim mund të përshtaten për të koordinuar punën e qendrës dhe shkollës sa më shumë të jetë e mundur.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 2

Takim për bashkëpunimin e terapistëve me mësues ndihmës – mësuesit ndihmës ndjekin punën e terapistëve në Qendrën Komunitare.

a) Qëllimi:

- Njohja me teknikat/ strategjitë specifike të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara
- Diskutimi mbi adresimin dhe menaxhimin e sjelljeve specifike që mund të shfaqin fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollë.

b) Pjesëmarrësit:

Pjesë e takimit u bënë:

- terapistët e qendrës,
- drejtuesja e rrjetit profesional të mësuesve ndihmës,
- mësueset ndihmëse në shkollat Xhafzotaj, Borakë/ Rubjekë (që kanë ose jo nxënës me aftësi të kufizuar që ndiqen në qendrën komunitare),
- psikologja e shkollave.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Fillimisht terapistët e qendrës prezantuan dhe demonstruan konkretisht punën me fëmijë që frekuentojnë shkollën por edhe fëmijë që nuk ndiqen nga mësueset ndihmëse. Gjatë ndjekjes së terapive u evidentua se si terapistët punojnë dhe adresojnë nevoja specifike të fëmijëve, të lidhura me sjelljen, marrjen e komandave, identifikimin, socializimin, etj. U mor feedback dhe përgjigje nga terapistët mbi pyetjet që ngritën mësueset ndihmëse lidhur me ecurinë e fëmijëve, punën me sjelljen e tyre apo vështirësi të tjera specifike. U theksua në takim rëndësia e bashkëpunimit me mësuesit e lëndëve në shkollë, identifikimit të aftësive të fëmijëve, si dhe përforcuesve të përshtatshëm për të nxitur përqendrimin apo bashkëpunimin e fëmijëve.

Rëndësia e trajnimit të vazhdueshëm të stafit në shkollë mbi punën me këta fëmijë, u evidentua si një nevojë e rëndësishme për përmirësimin e punës.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 3

Nxitja e bashkëpunimit midis mësuesve ndihmës dhe specialistëve të Qendrës Komunitare në Shijak.

a) Qëllimi:

- Qëllimi i kësaj veprimtarie synon ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikën e punës me fëmijët e spektrit autik e gjithëpërfshirës, nëpërmjet demonstrimeve të specialistëve në ambientet e qendrës.
- Demonstrimi i menaxhimit të sjelljes së fëmijës dhe përforsimit që mësuesit ndihmës duhet ti adaptojnë për të praktikuar më pas ato në situata të ndryshme me fëmijët gjatë procesit mësimor.

b) Pjesëmarrësit:

Pjesë e takimit u bënë:

- o mësuesja ndihmëse që punon në shkollën Rreth,
- psikologja e shkollës,
- fëmija me aftësi të kufizuara së bashku me prindin, si dhe
- specialistët e qendrës komunitare.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Prezantimi dhe demonstrimi konkretisht i punës me fëmijën gjatë orarit të terapisë në prezencë të mësueses dhe psikologes nga specialistja e qendrës. Në vijim të terapisë u evidentuan pikat e forta dhe pikat e dobëta të fëmijës si dhe u diskutua mbi objektivat e ngritura për tremujorin e ardhshëm të punës me fëmijën. U identifikuan aspektet në të cilat objektivat e lartpërmendura mund të përshtaten për të koordinuar punën dhe bashkëpunimin midis qendrës komunitare dhe shkollës, si dhe nxitja e ndërveprimit të fëmijës me aftësi të kufizuara për të ndërvepruar me fëmijët e tjerë. Eksperiencat e shkëmbyera dhe rezultatet e takimit në fund iu referuan edhe prindit të fëmijëve.

Foto nga veprimtaritë



**VEPRIMTARI TË REALIZUARA
NGA BASHKËPUNIMI I MËSUESVE NDIHMËS
DHE QENDRËS KOMUNITARE
NË URËN VAJGURORE**





Veprimtaria 1

Bashkëpunimi i specialistëve të qendrës me mësuesit ndihmës në shkollën “5 Maji”

a) Qëllimi:

- Qëllimi i veprimtarisë është ngritja e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikën e punës me fëmijët që frekuentojnë shkollën “5 Maji”, duke shkëmbyer eksperiencat midis profesionistëve për teknikat që mund të përshtaten në ambientet e klasës.


b) Pjesëmarrësit:

- Dy mësuesit ndihmës të shkollës “5 Maji”,
- Katër specialistë të qendrës komunitare.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Takimi u zhvillua në ambientet e shkollës midis mësuesve ndihmës dhe specialistëve të qendrës komunitare, ku në fokus është plani i veprimit të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët marrin shërbim në të dy institucionet. Në kuadër të këtij aktiviteti, secili pjesëmarrës, shkëmben eksperiencat e punës konkrete me fëmijën dhe përcaktohen nevojat bazë për mbarëvajtjen e programit individual në klasë. U vendos takimi i radhës në ambientet e qendrës, për të konsoliduar, në bashkëpunim me mësuesit ndihmës anëtarë të rrjetit profesional, hartimin e planit edukativ individual të përbashkët për secilin fëmijë me aftësi të kufizuara që merr shërbime në këto dy institucione njëkohësisht.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 2

Bashkëpunimi i specialistëve të qendrës me mësuesit ndihmës në shkollën Syzezë.

a) Qëllimi:

- Qëllimi i veprimtarisë është ngritja e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikën e punës me fëmijët që frekuentojnë shkollën “5 Maji”, duke shkëmbyer eksperiencat midis profesionistëve për teknikat që mund të përshtaten në ambientet e klasës.

b) Pjesëmarrësit:

- Një mësues ndihmës i shkollës së Syzezit,
- psikologja e shkollës, dhe
- katër specialistë të qendrës komunitare.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Takimi u zhvillua në ambientet e shkollës midis mësuesve ndihmës dhe specialistëve të qendrës komunitare, ku në fokus është plani i veprimit të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët marrin shërbim në të dy institucionet.

Në kuadër të kësaj, secili pjesëmarrës, shkëmben eksperiencat e punës konkrete të fëmijës dhe përcaktojmë nevojat bazë për mbarëvajtjen e programit individual në klasë.

U vendos takimi i radhës në ambientet e qendrës, për të konsoliduar rrjetin profesional për hartimin e planit edukativ individual të dakordësuar për secilin fëmijë me aftësi të kufizuara.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 3

Bashkëpunimi i specialistëve të Qendrës Komunitare me mësuesit ndihmës në shkollën Poshnje.

a) Qëllimi:

- Qëllimi i veprimtarisë është ngritja e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikën e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara që frekuentojnë shkollën “5 Maj”, duke shkëmbyer eksperiencat midis profesionistëve për teknikat që mund të përshtaten në ambientet e klasës.

b) Pjesëmarrësit:

- Një mësues ndihmës i shkollës së Poshnjes,
- Psikologjia e shkollës, dhe
- Dy specialistë të qendrës komunitare.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Takimi u zhvillua në ambientet e shkollës midis mësuesve ndihmës dhe specialistëve të qendrës komunitare, ku në fokus është plani i veprimit të edukimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët marrin shërbim në të dy institucionet. Në kuadër të kësaj, secili pjesëmarrës, shkëmben eksperiencat e punës konkrete të fëmijës dhe përcaktojmë nevojat bazë për mbarëvajtjen e programit individual në klasë. U vendos takimi i radhës në ambientet e qendrës, për të konsoliduar rrjetin profesional për hartimin e planit edukativ individual të dakordësuar për secilin fëmijë me aftësi të kufizuara.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 4

Koordinimi i veprimtarive ndërmjet mësuesve ndihmës dhe specialistëve

a) Qëllimi:

- Veprimtaria synon përcaktimin e nevojave specifike lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor të fëmijëve të spektrit autik. Shkëmbimin e përvojave praktike ndërmjet mësuesve ndihmës dhe specialistëve. Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikën e punës me fëmijët të spektrit autik. Përshtatja e mjedisit apo bazës materiale në qendër dhe në shkollë.

b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës që punojnë në shkollë të arsimit bazë,
- Terapistët e qendrës komunitare në Urën vajguore, dhe
- Psikolog.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Në këtë veprimtari mësuesit ndihmës së bashku me specialistët dhe psikologë diskutuan rreth mangësive dhe vështirësive që hasen në punën e tyre me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Diskutimi përfshinte çështje si:

- A janë të përshtatshme mjediset fizike për mbarëvajtjen e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara?
- A janë të përshtatshme tekstet mësimore për këta fëmijë?
- A bashkëveprojnë prindërit e tyre me mësuesin për një ecuri më efektive të fëmijëve?

Pjesëmarrësit shkëmbyen përvojat e tyre profesionale lidhur me punën me këta fëmijë. U vlerësua se çfarë është mirë dhe çfarë duhet bërë për të përmirësuar dhe lehtësuar punën me fëmijët e spektrit autik.


Rezultati që u arrit ishte rëndësia e koordinimit të punës ndërmjet mësuesve ndihmës dhe specialistëve të fushës lidhur me ecurinë e mëtejshme të procesit mësimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Foto nga veprimtaritë



VEPRIMTARI TË REALIZUARA NGA BASHKËPUNIMI I MËSUESVE NDIHMËS DHE QENDRËS KOMUNITARE NË LUSHNJË





Veprimtaria 1

Bashkëpunimi i terapistëve me mësuesit ndihmës - mësuesit ndihmës ndjekin punën e terapistëve në qendrën komunitare.

a) Qëllimi:

- § Ndërthurja dhe gërshetimi i punës së përbashkët mes terapistëve -mësuesit ndihmës - prindit.
- Gjetja e rrugëve dhe metodave sa më efikase për t'i ardhur në ndihmë femijës.

b) Pjesëmarrësit:

- Terapistet,
- mësues ndihmës,
- prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara,
- mësues kujdestar,
- psikologë, dhe
- punonjës social.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Gjatë zhvillimit të veprimtarisë, fokusi u përqendrua tek strategjitë dhe rrugët për arritjen e qëllimit, pyetje të ndryshme nga mësuesit ndihmës për terapistët për punën që ata bëjnë në qendrën komunitare me fëmijët me aftësi ndryshe, metodat kreative që përdorin ata për këtë kategori fëmijësh si dhe objektivat e vendosura për temën e takimit të radhës.

Ky takim pati rezultate pozitive për vazhdimësinë e punës me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 2

Tema: “Temë informuese mbi autizmin duke u mbështetur në kërkesat dhe nevojat e mësuesve ndihmës”.

a) Qëllimi:

- Veprimtaria synoi informimin e mësuesve për autizmin, ngritjen e kapaciteteve profesionale të mësuesve ndihmës në lidhje me praktikat e punës me fëmijët e spektrit autik, metodat e punës për të menaxhuar hiperaktivitetin , menaxhimi i sjelles, bashkëpunimi i vazhdueshëm me qendrën komunitare në Lushnjë.

b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës që punojnë në shkolla të arsimit bazë,
- prind të fëmijëve më aftësi të kufizuara,
- terapistët, dhe
- mësues kujdestarë.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:

Nëpërmjet demonstrimeve të specialistëve dhe terapistëve, mësuesit ndihmës u njohën më së miri me metodat dhe punën që bëhet në qendrën komunitare për t'i ardhur në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre.

Fokusi u vendos tek motivimi i pjesmarrësve, angazhimin e mësuesve ndihmës për të punuar me këtë kategori fëmijësh dhe u kërkua ndihma nga ana e prindërve dhe mësuesve ndihmës për një bashkëpunim sa më të shpeshtë dhe efektiv për të dyja palët. Mësuesit ndihmës, kërkuan takime sa më të shpeshta me terapistët e Qendrës.

Foto nga veprimtaritë





Veprimtaria 3

Veprimtari e përbashkët në këndin sportiv me fëmijë me aftësi të kufizuara që mbështeten nga mësuesit ndihmës të tyre dhe terapistët në Qendër.

a) Qëllimi:

- Veprimtaria synon zhvillimin e aftësive lëvizore të fëmijëve, argëtimin dhe zbavitjen e tyre dhe demonstrimin e lojrave të ndryshme të terapistëve për të kënaqur fëmijët.

b) Pjesëmarrësit:

- Mësues ndihmës që punojnë në shkollë të arsimit bazë, prind të fëmijëve, terapistë, të afërm të fëmijëve.

c) Përshkrimi i veprimtarisë:


Fëmijët së bashku me prindërit e tyre shkuan te këndi i lojrave duke u socializuar më shumë me njëri-tjetrin dhe duke u argëtuar së bashku.

Kjo veprimtari kishte vlera pozitive për fëmijët dhe strategjitë e përdorura ia arritën qëllimit.

Foto nga veprimtaritë



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al

